




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Fier**

Nr 70 Prot

Fier më, 05 .03.2025

Lënda: Njoftim për Vend të lir pune .

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit Nr 759 datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarisë menaxhimit të burimeve ,përberës së njesisë së zhvillimit të institucioneve ,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të personelit ”.

Ofruesi i AFP_së, Qendra e Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin me kohe të pjeseshme :

- instruktor i praktikës profesionale në kursin Anglisht (Fier) 1 person
- instruktor i praktikës profesionale në kursin Aftësi për Punësim (Lushnje) 1 person
- instruktor i praktikës profesionale në kursin Parukeri (Lushnje) 1 person
- instruktor i praktikës profesionale në kursin Servis Elektroauto në Automjetet e Lehta (Lushnje) 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryejë detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostroj aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale , pas te mesme ose parauniversitare në të njejtnë fushë me kualifikimin /kualifikimet profesionale per te cilin po aplikon .
- b) Të kete të paktën 3(vjet) përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet :
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit .

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë.

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në)
- c) kartën e indentitetit
- d) diplomë/deftese e shkollës së mesme
- e) librezë e punës
- f) çdo dukumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim CV;
- g) çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim i gjëndjes shëndetësore
- i) vërtetimin e gjëndjes gjyqësore
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara te tyre ; Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit të AFP-së brenda datës...13.03.2025

DREJTORI

Aleksander Lalaj

